



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme – Ministarstvo Inostranih Poslova – Ministry of Foreign Affairs

Mbështetur në nenin 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 9.1 (c) të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës, dhe

Në pajtim me nenin 4 (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 01/2007,

Nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 01/2010 PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË
MISIONET DIPLOMATIKE DHE KONSULLORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është sigurimi dhe pajisja me polisa të sigurimit shëndetësor të përfaqësuesve diplomatikë/konsullorë dhe anëtarëve të familjes së tyre të ngushtë, si dhe personelin vendor në shtetin pranues ku misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës janë të akredituara.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllimet e këtij Udhëzimi Administrativ, shprehjet në vijim kanë këto kuptime:

“**Familja e ngushtë**” nënkupton bashkëshortin/bashkëshorten dhe fëmijët nën moshën tetëmbjedhetë (18) vjeçare;

“**Ministria**” nënkupton Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës;

“**Ministri**” nënkupton Ministrin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës;

“Polisa e Sigurimit Shëndetësor” nënkupton pakot individuale të sigurimit shëndetësor që blihen për përfaqësuesit diplomatikë/konsullorë dhe familjet e tyre të ngushta si dhe personelin vendor;

“Shtetasi i Kosovës” nënkupton personin fizik i cili mban shtetësinë e Republikës së Kosovës ashtu siç përcaktohet në Ligjin për Shtetësinë e Kosovës.

Neni 3 Kualifikimi

1. Ministria paguan polisat e sigurimit shëndetësor për përfaqësuesit diplomatikë/konsullorë të Republikës së Kosovës jashtë vendit dhe familjes së tyre të ngushtë, përfshirë personelin administrativ dhe teknik si dhe familjen e tyre të ngushtë.
2. Ministria mbulon polisat për sigurim shëndetësor për personelin vendor të punësuar në misionet diplomatik dhe konsullorë, duke mos përfshirë familjen e tyre të ngushtë.
3. Sigurimi shëndetësor paguhet vetëm për fëmijët nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare.
4. Në rast se ndonjë zyrtar jep dorëheqje nga Shërbimi i Jashtëm apo caktohet në ndonjë detyrë tjetër brenda Ministrisë në Kosovë, ai/ajo nuk gëzon shërbimet e sigurimit shëndetësor, të mbuluara nga Ministria.

Neni 4 Lista e shërbimeve shëndetësore

Polisa e sigurimit shëndetësor e përcaktuar me këtë Udhëzim Administrativ mbulon shërbimet shëndetësore të përcaktuara në listën e shërbimeve shëndetësore, e cila i është bashkangjitur këtij Udhëzimi Administrativ dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 5 Ekzaminimi mjekësor

1. Të gjithë zyrtarët e shërbimit të jashtëm që kanë të drejtën e pajisjes me polisën e sigurimit shëndetësor, paraprakisht duhet t'i nënshtrohen ekzaminimeve mjekësore dhe të pajisen me certifikatë mjekësore në Republikën e Kosovës apo në shtetin pranues.
2. Sipas legjislacionit në fuqi, raporti mjekësor konsiderohet konfidencial dhe ruhet në Divizionin e Personelit pranë Ministrisë. Vetëm personat e autorizuar sipas legjislacionit kanë qasje në Raport.

Neni 6 Buxheti

1. Pagesa e sigurimit shëndetësor bëhet nga buxheti vjetor i alokuar për misionet diplomatike dhe konsullore.
2. Nëse ndonjë nga misionet diplomatike dhe konsullore nuk e shpenzon linjën e vet buxhetore të alokuar për blerjen e polisave të sigurimit shëndetësor, mjetet financiare mund t'i alokohen një misioni tjetër në pajtim me procedurat ligjore.

Neni 7 Procedurat

1. Shefi i Misionit Diplomatik autorizohet të kryejë procedurat për kontraktimin e polisave të sigurimit shëndetësor me kompanitë e regjistruara në shtetin pranues.
2. Shefi i Misionit i dërgon Ministrisë së paku tri (3) oferta nga kompanitë e regjistruara në shtetin pranues.
3. Pranë Ministrisë themelohet një komision prej tre (3) anëtarësh, i përbërë nga përfaqësues të Departamentit për Prokurim, Departamentit për Buxhet dhe Financa dhe Departamentit të Administratës, i cili bën vlerësimin e ofertave, dhe merr vendimin për miratimin e një oferte. Vendimi merret mbi bazën e parimeve të jo-diskriminimit, transparencës dhe ekonomicitetit.
4. Vendimi për miratimin e një oferte, i dërgohet shefit të misionit, i cili obligohet për finalizimin e procedurave për kontraktim të polisave të sigurimit shëndetësor.

Neni 8 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Ministri i Punëve të Jashtme.

Skender Hyseni

Ministër i Punëve të Jashtme

Prishtinë, 14 janar 2010



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme – Ministarstvo Inostranih Poslova – Ministry of Foreign Affairs

Lista e Shërbimeve të lejuara
Shërbimet në spital
Dhoma në spital
Transporti për në spital
Shpenzimet për kirurgët, mjekët, specialistët, dhe anestezistët
Shpenzimet për materialet dhe qiraja e dhomës së operimit
Kujdesi intensiv
Fizioterapi
Ilaçet e këshilluara nga mjeku dhe fashat
Protezat dhe pajisje mjekësore të ngjashme
Shërbimet në rast mos shtrimi në spital
Shpenzimet për mjekun e përgjithshëm
Shpenzime për mjekun specialist
Kujdesi parandalues
Fizioterapi
Kirurgjia ditore
Ilaçet e këshilluara nga mjeku
Shërbimet tjera
Shërbimi i ambulancës në rrugë
Shpenzime për shtatzëni normale
Komplikime të shtatzënisë dhe lindjes
Sigurimet shëndetësore gjatë udhëtimit
Trajtimi urgjent
Evakuimi Mjekësor / Riatdhesim urgjent